

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGTARE ME ORTAK TE VETEM  
“ALDI TRAVEL ” SH.P.K  
ME SELI NË TIRANË**

\*\*\*

Sot, më datë 21/11/2022, në Tiranë,

Z. **Aldi Arben Isaku**, shtetas shqiptar, lindur në 12/06/2000, në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin Nr. K00612057S.

I cili ka vendosur themelimin e shoqërisë **“ALDI TRAVEL ” SH.P.K**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar me ortak te vetëm, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

SHOQËRIA TREGTARE **“ALDI TRAVEL ” SH.P.K** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” I ndryshuar, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar . Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare perfaqesimi dhe agjenci në shqipëri edhe jashtë shtetit.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“ALDI TRAVEL ” SH.P.K.**

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë në fushat e mëposhtme: Në fushën e turizmit, hotelerisë, shitje/blerje, biletash aviacioni, trageti autobuzi dhe apo mjete të ndryshme të organizimit të formave të ndryshme të udhëtimit turistike, udhëtime pune, shitje blerje të paketave turistike, organizimin e eventeve zyrtare dhe jo zyrtare si ditëlindjet dhe festat, Udhetime Turistike me grupe te organizuara brenda dhe jashte vendit. Shitje blerje biletash per evente sportive dhe evenimente te ndryshme kulturore dhe artistike. Makina me qera. siguracion shendeti ne udhetim. Organizim turesh brenda dhe jashte vendit. Pushime dhe udhetime me kroeciera. Shoqeria bashkepunon me agjenci te tjera turistike, udhetimi, shoqeri transportesh etj, vendase dhe / apo te huaja, hotele, resorte, restorante, individe, familje etj, qe kane objekt 2 veprimtarie te njejte me te apo qe lidhen me objektin e saj te

  
Aldi Isaku

veprimtarise. Shoqeria do te kryeje aktivitet ne fushen e promovimit te turizmit vendas e te huaj, bashkepunim me agjenci, persona juridike, fizike, individe, institucione te ndryshme shteterore / publike / private, etj; Shoqeria organizon ture te ndryshme te permasave te ndryshme ne pjesemarrje, objektiv udhetimi, qelime udhetimi. etj, te ndryshme, brenda dhe jashte vendit, ne perputhje me legjislacionin e RSH dhe ate nderkombetar. Shitje te produkteve te agjensise (bileta avioni, bileta autobusi, makina me qera, transferta, eskursione, rezervime apartamentesh dhe hotelesh, udhetime turistike.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Rr."Agim Qarri", Unaza e re, Ndertesa nr.3, në Yzberisht, Komuna Kashar, Tiranë.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe eshte 1 (një) kuote.

Themeluesi merr ne pronesi kuoten e tij ne kapitalin themeltar ne perputhje me kontributin e tij.

Kontributi i ortakut themelues ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

z. Aldi Isaku , me vlere 100 Lek, zoteron 100 % (njeqind ).

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Aktivitete tregtare mbyllen në datën 31 dhjetor të çdo viti. Aktiviteti i parë tregtar do të mbyllet në datën 31 dhjetor 2022.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm ;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administrator i Shoqërisë, i cili pranon, Z. **Aldi Arben Isaku**, shtetas shqiptar, lindur në 12/06/2000, në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin Nr. K00612057S.

Aldi Isaku

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative që:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

#### **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 9**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 10**

##### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortaku themelues dhe të legalizohet përpara noterit ditën e themelimit, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 11**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortaku i vetëm, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

#### **NENI 12**

##### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në dy kopje në gjuhën shqipe u lexua nga Ortaku Themelues i cili e gjeti atë në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe e nënshkroi pa vërejtje.

**ORTAKU I VETËM THEMELUES**

**ALDI ISAKU**

